



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

EKSTRAKT

Nga procesverbali i mbledhjes së 40-të të Komitetit për Komunitete të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 07.07.2025, në sallën numër 2 kati i 3-të, në ora 13,⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Skender Bikliqi, kryesues
2. Gentianë Hoxhaj, anëtare
3. Shahadije Bikliqi-Dragaçina, anëtare
4. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
5. Enver Kryeziu, anëtar
6. Zoran Cirkovic, anëtar
7. Slavisa Trajkovic, anëtar
8. Olga Gucic, anëtare
9. Idajet Garip, anëtar

Të tjerë prezent

1. Sead Aliu, drejtor për infrastrukturë
2. Përfaqësues të UNMIK-ut
3. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Merita Mustafa**.

Kryesuesi i Komitetit Skender Bikliqi, pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se rendin e ditës e keni marrë me kohë dhe e lexoi në vazhdim:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e 39-të
2. Informatë nga drejtorati për infrastrukturë, rreth punimeve të cilat po zhvillohen në terren.
3. Të ndryshme

I

Aprovimi i Ekstraktit nga mbledhja 39-të e Komitetit për Komunitete

Lidhur me këtë pikë, kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, pyeti anëtarët e Komitetit, se a ka dikush vërejtje, apo plotësime të ekstraktit nga mbledhja 38-të e Komitetit për Komunitete?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit, konstatoi se Komiteti unanimisht aprovoi të njëjtin.

II

Informatë nga drejtorati për infrastrukturë, rreth punimeve të cilat po zhvillohen në teren.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi , ia kaloi fjalën Sead Aliu, drejtor i infrastrukturës i cili i njoftoi anëtarët e komitetit rreth punimeve të cilat po zhvillohen në teren.

Pastaj kryesuesi hapi diskutimin.

Idajet Garip, tha se në Janjevë ka nevojë për investime pasi që janë disa rrugica që jetojnë komunitetet jo shumicë ku duhet të investohet dhe të vizitohen nga ana juaj dhe të shikohet si është gjendja.

Skender Bikliqi, tha se edhe unë pajtona me parafolësin se në Janjevë ka nevojë për disa investime pasi që Janjeva ka mbet keq si për ujë të pijes ashtu për ndriçim publik në disa lagje po ashtu edhe për kanalizim.

Sead Aliu, tha se në Janjevë është investuar dhe po vazhdon të investohet ende dhe kemi planifikuar edhe disa projekte të reja po ashtu ka dhe investime edhe në fshatrat tjera.

Shahadije Dragaçina, tha se a keni planifikuar ndonjë investim për ujë të pijes për Janjevë.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se kur pritet të përfundoj projekti i nënkalimit. Tjetra kur pritet të përfundoj trotuari me ndriçim publik në rrugën “Banush Sadllari” në Shalë kur pritet të përfundoj. Po ashtu kur pritet të filloj ndriçimi publik në rrugën “Gjergj Fishta” në Lipjan tek shkolla fillore.

Sead Aliu tha se projekti i nënkalimit pritet të përfundoj kah fundi i gushtit. Ndriçimi publik në disa rrugica do të filloj shumë shpejt ndërsa për trotuar për momentin nuk kemi mjete.

Zoran Cirkovic, tha se pse nuk po përfundon që një kohë të gjatë rruga kryesore në Grackë,ku jetojnë të gjitha komunitetet së bashku me ndriçim publik.

Olga Guciq tha se rruga në Janjevë që shkon për Teqe është në gjendje jo të mirë po ashtu ka probleme edhe me ujë të pijes që një kohë të gjatë.

Pasi diskutime tjera nuk pati u kalua në pikën në vazhdim.

III

Të ndryshme

Meqë çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 14¹⁰.

Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit
Skender Bikliqi